



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2226/23 datë:20.01.2023



Npi – 01/32 datë: 27.01.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d), Nenin 17 pika (k), dhe Nenin 24, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me shkresën Nr.07/02 të datës 19.01.2022 i propozon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të merr vendim për ndarjen nga 100€ të specifikuara për destinimin e veçantë për Nënata-Lehona për çdo lindje të fëmijut në vitin 2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022 që nuk kanë pas mundësi me aplikuar, në vitin 2022, për banorët e Komunës së Shtimes. Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi propozimin e Drejtorisë, dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27.01.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 100 € PËR NËNAT-LEHONA PËR ÇDO FËMIJË TË LINDUR NË VITIN 2023

I

Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më 27.01.2023, unanimitisht miratoi Vendimin për ndarjen nga 100€ (njëqind euro) për secilën Nënë-Lehonë, për ç'do fëmijë të lindur në vitin 2023, si dhe për fëmijët e lindur në vitin 2022 e të cilët nuk kanë pas mundësi me paraqitur kërkesën për realizimin e të drejtës së tyre, gjatë vitit 2022.

II

A r s y e t i m: Vendimi për ndarjen nga 100€ për ç'do fëmijë të lindur gjatë vitit 2023 është votuar unanimitisht nga anëtarët e Kuvendit, duke marrë për bazë edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe duke marrë për bazë edhe rritjen e Buxhetit të Komunës së Shtimes në programin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale pika 4 (Subvencione dhe Transfere) nga 55,234 € në vitin 2022, në shumën prej 132,734 €, në vitin 2023.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës Komunale për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi